



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSTITUTI I STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT  
KËSHILLI SHKENCOR

Nr. 354 prot

Tiranë më 13 / 11 / 2025

PROCESVERBAL

MBLEDHJE KËSHILLI SHKENCOR

(Datë, 13.11.2025)

**Të pranishëm nga Këshilli Shkencor:** Z. Ardian Muhaj, Z. Vehap Kola, Z. Edlir Orhani, Znj. Enriketa Pandelejmoni, Znj Gentiana Kera, Znj. Ines Stasa.

**Rendi i ditës:**

1. Diskutim mbi rregulloren e botimeve të ISKK- së

*Hapet mbledhja.*

Mbledhja u hap duke pasur parasysh Rregulloren e Botimeve dhe duke shqyrtuar nen për nen , me qëllim identifikimin dhe sygjerimin e ndryshimeve të nevojshme.

**Znj. Gentiana Kera:** Neni 3 është pika e dytë (*garanton kontributin e padyshimtë shkencor*) unë do e hiqja këtë të padyshimt, dyshim ka në shkencë gjithmonë por kjo është fjalë e tepërt nuk i ndryshon brendin.

**Znj. Ines Stasa:** Mund të jetë kontribut original ose autentik shkencorë, ashtu si na kërkohet të gjithëve por jo i padyshimtë. (*Garanton kontributin origjinal shkencorë, dokumentues, dëshmues apo letrar*) dhe këtë letrat me pikëpyetje e kam.

**Znj. Gentiana Kera:** Letrari mund të jetë me element autobiografik, mund të lihet letrat që ka lidhje me periudhën.

**Znj. Enriketa Pandelejmoni:** Te neni 4 pika 2 (*Librat me kujtime të të dënuarve politikë mund të jenë shkruar nga vetë personi, ose mund të jenë përgatitur përmes intervistash*), kur është kujtime ose do futet te zërat e kujtesës për ta specifikuar, kujtimet janë tjetër gjë, do doja të hiqej kjo të jenë përgatitur përmes intervistash, librat me kujtime të të dënuarve është libër me kujtime nga vetë i dënuari, për sa i përket dëshmive të të dënuarve të hyjë te zërat e kujtesës.

**Znj. Gentiana Kera:** Varet se mund të ketë njerëz që merren në intervist por nuk janë në gjendje për të shkruar vetë, nuk është qëllimi që të bëhet punim shkencorë mbi bazën e intervistës, ky është botim i intervistës, janë kujtime të 10 vetave që bashkohen në një vëllim.

**Znj. Enriketa Pandelejmoni:** e kam te kjo ose mund të përgatiten mes intervistash, e kam te fjalia të ndahet. Pika dy më stonon, duhet një rifolmulim.

**Znj. Ines Stasa:** Të ndahet të bëhet në dy fjali jo në një fjali.

**Znj. Gentiana Kera:** Do bëhet librat me kujtime mund të jenë në formën—shkruar nga vetë personi

**Znj. Enriketa Pandelejmoni:** Nuk kemi ne këtu intervistat, këtu duhet ta shtojm intervistat me ish të burgosur.

**Znj. Gentiana Kera:** Kujtimet marrin formë me botimin e intervistave.

**Znj. Enriketa Pandelejmoni:** Te pika dy duhet futur kujtimet e të dënuarve politik, intervista nga stafi, te neni dy pika dy. Dëshmi gojore në formën e intervistave të regjistruara nga punonjës të ISKK- së, punonjës të specializuar të ISKK- së ose punonjës shkencorë. Te neni 4 pika dy dhe dëshmitë gojore mund të jenë të shkruara nga vetë personi.

**Znj. Ines Stasa:** Neni dy pika dy, kujtimet e të dënuarve politikë- të burgosur, internuar e dëbuar, dëshmi gojore të përgatitura përmes intervistave. Te neni 7 kjo fjala (*popullarizim*) ta heqim ta zvendësojm me promovuese.

**Znj. Enriketa Pandelejmoni:** Te neni 4 pika 4, jo (*ose në formë tjetër*) por dhe në rrugë elektronike.

**Znj. Gentiana Kera:** Ka gabime gramatikore dhe fjalë.

**Znj. Ardian Muhaj:** Po ka shumë gabime.

**Znj. Ines Stasa:** Te neni 7 mund të jetë botimet promovuse jo (*përuruse*) dhe heqim fjalën (*popullarizuse*).

**Znj. Gentiana Kera:** Bën botime për pasqyrimin e veprimtarive.

**Znj. Enriketa Pandelejmoni:** Në varësi të veprës duhet dhe stili i shkrimit.

**Znj. Ines Stasa:** Po të ketë një formë të unifikuar, kur të dalin studimet të dalin në të njëjtën referenc.

**Znj. Ardian Muhaj:** Nëse autori zgjedh një stil vetë duhet ti qëndrojë deri në fund, duhet të jetë koncekuent.

**Znj. Ines Stasa:** Te neni 5 dhe neni 6 të shtojmë mënyrën dhe stilin e citimit të referencës I cili do jetë Chicago.

**Znj. Gentiana Kera:** Unë jam vetëm për Chicago.

**Znj. Enriketa Pandelejmoni:** Te veprat shkencore duhet të futet stili references.

**Znj. Ines Stasa:** Te neni 5 pika 2, te shtohet stili Chicago. Te neni 7 në fund (*Botimet përuruse dhe ato popullarizuese bëhen me vendim të Bordit Drejtues*), botimet me qëllim pasqyrimin e aktivitetit bëhen me vendim të Bordit Drejtues.

**Znj. Enriketa Pandelejmoni:** Te neni 6 pika e fundit (*Drejtoria përgjegjëse kujdeset Brenda mundësive, për indeksimin shkencor të tyre në listat me njohje ndërkombëtare*), duhet të insistohet te Ministria e Arsimit për indeksimin.

**Znj. Gentiana Kera:** Te neni 10 pika 3, këtë (*qortimit*) nuk e kuptojë të bëhet përpunimi i imazhit. (*Dorëshkrimi mund të mos pranohet për botim nëse nga verifikimi nuk krijohet siguri*) në këtë rast nuk ka pse të hiqet gjithë

dorëshkrimi, hiqet imazhi dhe të kërkohet leje për imazhet që përdoren duhet burimi.

**Znj. Ardian Muhaj:** (*Qortimin*) e ka përdorur në kuptimin e korigjimit të imazhit të dikujt.

**Znj. Enriketa Pandelejmoni:** Te neni 10 nuk mund të themi (*Manipulimi imazhit*) por përdorimi i imazhit. Pika 10 paragrafi i parë, Imazhet që do të përdoren për botim nga Iskk duhet të jenë të autorizuara dhe me burimin e informacionit të saktë. Përdorimi i imazhit në botimet e Iskk duhet të jenë të pajisura me referencën e plotë të burimit.

**Znj. Ardian Muhaj:** Botimi i dorëshkrimit pezullohet deri sat ë arrihet siguri nga verifikimi, ndryshe do hiqet imazhi.

**Znj. Gentiana Kera:** Dorëshkrimi refuzohet në rast se një imazh uk verifikohet, do hiqet imazhi dhe imazhi nuk përfshihet në botim. Të drejtën e autorit mund ta mbajë autori dhe institucioni qe e financon, më duket pak e paqart kush e ka prandaj dhe po pyes, se për sa kohë e financon Iskk-ja duhet të jetë e Iskk- së. Sipas nenit 11 është me kontratë.

**Znj. Ardian Muhaj:** Te neni 11 nuk është me të drejtën e autorit por me konceptin e autori, një nga botimet e djeshme të drejtat ja kish mbajt vetes ai, këtu maksimumi është iskk dhe autori.

**Znj. Enriketa Pandelejmoni:** Nenin 11 do e lëm si është . Te neni 12 (*pavarësisht... autor i veprës*) të hiqet.

**Znj. Gentiana Kera:** Nenin 11 dhe 12 ti bashkojmë me emrin Autorsia.

**Znj. Enriketa Pandelejmoni:** Te neni 12 referuar ligjit të vendoset Nr. 35 dhe data 2016.

**Znj. Gentiana Kera:** Te neni 12 në fund (*të entit botues*) të vihet dhe ISKK direkt, dhe te (*Titullari i të drejtës së autorit*) te zvendësohet me Zotëruesi i të drejtës së autorit.

**Znj. Enriketa Pandelejmoni:** Do sygjeroja që botimet e Iskk-së të shiteshin, librat të kenë një çmim. Duhet tja kërkojm Bordit dhe Bordi tja kërkojë parlamenetit.

**Znj. Gentiana Kera:** Duhet parë ligji. Me që janë falas të publikohen te faqja e Iskk- së.

**Znj. Enriketa Pandelejmoni:** Te neni 16 të shtohet pika 3 Botimet e Iskk- së me akses të lirë për open akses, falas online.

**Znj. Gentiana Kera:** Botimet e plota të ISKK- së të jenë të aksesueshëm në faqen WEB.

**Znj. Ardian Muhaj:** Do sygjeroja që mbledhja e fundit të ishte miratimi i rregullores, që kur ta çojm te Bordi ta kemi dhe gjuhësisht në rregull, sepse Bordi nuk ka detyrë të ndërhyjë në rregollore.

**Znj. Gentiana Kera:** Cili do ishte afati maksimal që ne të bëjmë vlerësimet tona.

**Znj. Brisejda Lala:** Nga jashtë është mbyllur thirrja vetëm 4 botime janë. Deri në fund të Shkurtit fillim Marsi mirë do ishte të dorëzoheshin, pasi më vonë kalojnë në redaktim te Violeta.

**Znj. Ines Stasa:** Ne e shqyrtuam rregulloren sot.

**Znj. Enriketa Pandelejmoni:** Violeta duhet ta redaktoj rregulloren e botimeve, dhe ta zbardh në formë letrare që ne ta miratojm.

**Vendime:**

1. Shqyrtim i rregullores.
2. U përcaktua stili zyrtar i botimeve shkencore.
3. Afati i dorëzimit të botimeve pasi ti ketë shqyrtuar Kwshilli Shkencor.

*Mbledhja mbyllet.*

**Ardian Muhaj Kryetar**.....  
**Vehap Kola Anëtar**.....  
**Edlir Orhani Anëtar**.....  
**Enriketa Pandelejmoni Anëtar**.....  
**Gentiana Kera Anëtar**.....  
**Ines Stasa Anëtar**.....

**Përpiloi: Daniela Runa**